

---

## RELACION TEKNIK

---

*Zhvillimi i linjave TM 20kV, kabinave elektrike dhe linjat TU me përcjellës ABC, për fiderat O1 dhe O2 nga N/Stacioni Orikum 110/35/20kV për furnizimin me energji elektrike të zonës Radhimë.*

## Përmbajtja e lëndës

1. INFORMACIONI I PERGJITHSHEM .....	2
2. HYRJE .....	3
i. Objekti i Relacionit Teknik .....	4
ii. Përmbajtja e Relacionit .....	4
iii. Referimet Ligjore dhe Teknike .....	5
iv. Referimet teknike .....	5
3. KERKESAT AMBIENTALE DHE PARAMETRAT ELEKTRIK TE SISTEMIT	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
<b>defined.</b>	
i. Kerkesat ambientale: .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
ii. Parametrat e rrjetit 20 KV: .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
4. ZONA E PROJEKTIT .....	6
i. Pozicioni Gjeografik .....	6
5. PROJEKTI I RI .....	6
ii. Të përgjithshme .....	6
iii. Projekti i Linjës 20kV përmban : .....	7
6. PLAN VENDOSJA E FIDERAVE TE RINJ .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7. Kriteret e projektimit .....	7
i. Përcaktimi i ngarkesës elektrike të pritëshme. ....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
ii. Kategoria e konsumatorëve .....	7
iii. Transporti .....	8
8. SIGURIA NE PUNE .....	8
9. KONCEPTI I ZBATIMIT .....	8
i. Të përgjithshme .....	8
ii. Siguria në punë dhe në shfrytëzim. ....	8
iii. Analiza e Riskut .....	8
iv. Çështjet ambientale .....	9
v. Dokumentacioni .....	11
10. Referencat .....	11
11. GRUPI PROJEKTIMIT .....	11

## 1. INFORMACIONI I PERGJITHSHEM

Ky projekt parashikon hartimin e projektit te rrjetit te ri shperndares te tensionit te mesem 20 kV, ndertim te kabinave te reja tip Box dhe dhe rrjetit TU me kabell me vetembajtje ABC, N/ST Orikum i ri 110/35/20 kV.

Performanca e rrjetit eshte e ulet dhe e ndervarur nga rritja e kerkeses per konsum energjie si zone turistike. Kjo situata kerkon nje zgjidhje te shpejte per te pasur nje furnizim te pa nderprere me energji.

<b>Emertimi Objektiv</b>	<b>"Zhvillimi i linjave TM 20kV, kabinave elektrike dhe linjat TU me percjelles ABC, per fiderat O1 dhe O2 nga N/Stacioni Orikum 110/35/20kV per furnizimin me energji elektrike te zones Radhime. "</b>																																	
Vlera Projektit	456,855,685.16 leke pa TVSH																																	
Investitor	OSSH sh.a.																																	
Projektues	OSSH sh.a. Ing. Elektrik : Klajdo Selmanhasko Ing. Elektrik : Venera Sinjari Ing. Elektrik : Erisa Avdulaj Ing. Elektrik : Anxhela Lamaj Ing. Mjedisi : Anila Kasa Ing. Ndertimi : Drilona Todhe			Liç. E..... E..... N..... M.																														
Burimi Financimit	OSSH sh.a.																																	
<b>Baza Materiale Kryesore</b>																																		
Numri i Fiderave te rinj	Fideri O1 kabllor 20 kV N/St Orikum i ri 110/35/20 kV L=16.8 km		Fideri O2 kabllor 20 kV N/St Orikum i ri 110/35/20 kV L=12.15 km																															
Numri i Kabinave:	Fideri O1 : - 11 Kabina te reja tip box - 3 Kabina rikonstruksion - 1 Kabine murature (Hyrje –dalje)		Fideri O2 : - 19 Kabina te reja tip box - 3 Kabina rikonstruksion - 9 Kabina murature (Hyrje –dalje)																															
Numri i transformatore ve te Fuqise	<table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Emertimi Fiderit</th> <th colspan="5">Fuqia e Transformatorit (Kva)</th> </tr> <tr> <th>100</th> <th>160</th> <th>250</th> <th>400</th> <th>630</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td><b>O1</b></td> <td></td> <td></td> <td>8</td> <td>7</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td><b>O2</b></td> <td>1</td> <td>1</td> <td>10</td> <td>19</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td><b>TOTALI</b></td> <td><b>1</b></td> <td><b>1</b></td> <td><b>18</b></td> <td><b>24</b></td> <td><b>0</b></td> </tr> </tbody> </table>					Emertimi Fiderit	Fuqia e Transformatorit (Kva)					100	160	250	400	630	<b>O1</b>			8	7	0	<b>O2</b>	1	1	10	19	0	<b>TOTALI</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>18</b>	<b>24</b>	<b>0</b>
Emertimi Fiderit	Fuqia e Transformatorit (Kva)																																	
	100	160	250	400	630																													
<b>O1</b>			8	7	0																													
<b>O2</b>	1	1	10	19	0																													
<b>TOTALI</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>18</b>	<b>24</b>	<b>0</b>																													
Gjatesia e linjes TM:	Linja TM kabllore 20 kV e Fiderit O1 do te realizohet me kabllor gershet XLPE 3x(1x240)mm <sup>2</sup> Al me gjatesi L=16.8km Linja TM kabllore 20 kV e Fiderit O2 do te realizohet me kabllor gershet XLPE 3x(1x240)mm <sup>2</sup> Al me gjatesi L=12.15km																																	
Gjatesia e linjave TU:	Kabllor ABC me vetembajtje: 28.8km																																	
Numri Abonenteve te prekur nga investimi:	-850 abonente																																	
Karakteristikat kryesore te abonenteve ne zone:	Zona e projektit perbehet nga abonente familjare dhe biznese te zones se Radhimes ne qytetin e Vlores.																																	
Siperfaqe totale e zones se perfshire ne project:	12 km <sup>2</sup>																																	
Qellimi i realizimit te projektit	Me realizimin e ketij projekti synohet permiresimi i furnizimit me energji elektrike te Zones se Radhimes ne qytetin e Vlores.																																	
<b>Treguesit e Cilesise</b>																																		
	Humbjet aktuale: %																																	
	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i Tensioni (Kv)</th> <th>Emertimi Fiderit</th> <th>Konsum Vjetor kwh/ vit</th> <th>Humbje ne kwh ne vit</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td><b>10</b></td> <td>R1</td> <td>6,251,112</td> <td>1,312,734</td> <td>21%</td> </tr> </tbody> </table>					Niveli i Tensioni (Kv)	Emertimi Fiderit	Konsum Vjetor kwh/ vit	Humbje ne kwh ne vit	%	<b>10</b>	R1	6,251,112	1,312,734	21%																			
Niveli i Tensioni (Kv)	Emertimi Fiderit	Konsum Vjetor kwh/ vit	Humbje ne kwh ne vit	%																														
<b>10</b>	R1	6,251,112	1,312,734	21%																														

Humbjet e energjise	<b>10</b>	R2	3,197,232	607,474	19%		
	<b>10</b>	R3	7,061,184	1,412,237	20%		
Humbjet teknike pas investimit: pritet te ulen me 2% ne rrejetin 20 kV							
SAIDI	Nr	N/st	TM/ TL	Nr Abonenteve	SAIDI		
	1	N/ST Radhima 35/10 kV	R1	1495	244.13		
			R2	832	204.6		
			R3	3585	137.9		
SAIFI	Nr	N/st	TM/ TL	Nr Abonenteve	SAIFI		
	1	N/ST Radhima 35/10 kV	R1	1495	121.2		
			R2	832	72.4		
			R3	3585	76.3		
Konsumi aktual i energjisë ne zonë	16, 509, 528 kWh në vit						
Rritja e pritshmërisë e konsumit ne zone	+1% ne vit						
Jetegjatesia e rrjetit	30 vjet						
Parametrat teknik te linjave te reja							
Rryma nominale e fiderit	Fideri O1 - $I_n = 162$ A Fideri O2 - $I_n = 340$ A						
Fuqia maksimale e instaluar ne fidera	Emertimi Fiderit	Fuqia e Transformatorit (Kva)				Fuqia max e Instaluar ne fider (KVA)	
		<b>100</b>	<b>160</b>	<b>250</b>	<b>400</b>		<b>630</b>
	<b>O1</b>			8	7	0	5030
	<b>O2</b>	1	1	10	19	0	10590
<b>TOTAL</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>18</b>	<b>24</b>	<b>0</b>	<b>15 620</b>	
Simulimi i	Emertimi Fiderit	Gjatesia maksimale	Humbjet teknike TM	Renia maksimale e tensionit	Tensiononi Maksimal (Tensioni Linjes)	Tensioni minimal (Linjes)	Rryma ne dalje te fiderit
		km	%	%	kV	kV	kA
	Fideri O1	13.3	2.42	4.37	19.97	0.38	0.120
	Fideri O2	12.1	2.85	5.09	19.91	0.38	0.246

## 2. HYRJE

Zona e Radhimes eshte pjese e Bashkise Orikum te rrethit te Vlores. Ai ndodhet ne pjesen jugore te qytetit te Vlores, tashme gati e bashkuar me periferine e qytetit.

Është një ndër zonat bregdetare më të frekuentuar gjatë verës i cili se fundmi po karakterizohet nga një zhvillim intensiv dhe keta faktore kane bere qe ritmet e rritjes se kerkeses per energji elektrike te jene mjaft te larta. Për zonën duhet nje rikonstruksion dhe shtim i kapaciteteve te infrastruktures elektrike te përshtatshme, që të garantojë një shërbim cilësor kundrejt konsumatoreve aktual dhe njëkohësisht të jetë në përputhje me zhvillimet e pritshme afatgjata të zonës. Referuar strategjisë së zhvillimit dhe përmirësimit të rrjetave elektrike që kompania OSSH sh.a. ka, ndër të tjera dhe normalizimin e ngarkesave në linja TM dhe TU.

Projekti permban ndertimin fiderave te rinj O1 dhe O2 me parmetra 20kv me kabell XLPE 3x(1x240)mm<sup>2</sup>, ndertimin e 30 kabinave te reja, rikonstruksion te kabinave ekzistuese, linje TU me kabell me vetembajtje ABC.



Figure 1 Foto nga Radhima

### **i. Objekti i Relacionit Teknik**

Objektivi i relacionit teknik të projektit është për të përmbledhur konceptin dhe kriteret e projektimit të përdorura për hartimin e projektit të detajuar dhe dhënë rezultatet e projektit të detajuar për ndërtim linje TM, kabina dhe linja TU me kabell ABC për fiderat O1 dhe O2, N/st Orikum i ri 110/35/20 kV"

### **ii. Përmbajtja e Relacionit**

Ky Relacion është hartuar në përputhje me kërkesat e Detyrës së Projektimit për hartimin e projektit.



Figure 2 Vendndodhja gjeografike e zones – Qyteti Sarande

### iii. Referimet Ligjore dhe Teknike

- Ligji Nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”
- Vendimi i ERE nr.100, date 26.8.2008 “Kodi\_Shpërndarjes”
- Vendimi i ERE nr.101, date 2.8.2008 “Kodi Matjes”
- ERE “Per Lidhjet e Reja ne Sistemin e Shpërndarjes”
- “Rregullore e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik per Impiantet, Instalimet dhe Paisjet Elektrike”
- Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”
- Vendim i KM nr.564, datë 3.7.2013 Për miratimin e rregullores “Për kërkesat minimale te sigurise dhe shendetit ne vendin e punes”
- VKM 482 17.6.2020 “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së linjave elektrike me tension të lartë mbi 1 kV”
- VKM 483 17.6.2020 “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë së instalimeve elektrike të tensionit të lartë, mbi 1 kV”
- Ligji nr.8405, date 17.9.1998 per “Urbanistiken”
- Ligji nr.8402, date 10.9.1998 per “Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”
- Ligji Nr. 10 440, dt 7.7.2011 “Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis”
- Ligji Nr.9537 date 18.05.2006 “Per Administrimin e Mbetjeve te Rrezikeshme ( i permiresuar me LigjinNr.9890 date 20.03.2008)”
- Ligji nr. 8934, date 5.9.2002 per “Mbrojtjen e mjedisit”
- Ligji nr. 8906, datë 6.6.2002 “ Për zonat e mbrojtura ”
- VKM Nr.249, dt 24.04.2003 “Për Miratimin e Dokumentacionit për Leje Mjedisore dhe të Elementeve të Lejes Mjedisore

### iv. Referimet teknike

- Puna duhet të kryhet në përputhje me kodet, standartet, rregullat për parandalimin e incidenteve. Puna duhet të përmbushë standardet e përmendura me sipër dhe praktikatat e rekomanduara. Referimet teknike kryesore janë:
- SSH EN 60947 Pajisjet shpërndarëse dhe te kontrollit të tensionit të ulët (Low-voltage switchgear and controlgear)
- S SH EN 50274:2002: Tërësia e pajisjeve shpërndarëse të tensionit të ulët - Mbrojtja nga goditja elektrike - Mbrojtja nga kontakti i drejtpërdrejtë i paqëllimshëm me pjesët e rrezikshme nën tension
- SH EN 50274:2002/AC:2009: Tërësia e pajisjeve shpërndarëse të tensionit të ulët - Mbrojtja nga goditja elektrike - Mbrojtja nga kontakti i drejtpërdrejtë i paqëllimshëm me pjesët që përbejnë rezik për jetën
- SSH EN 60898-2:2006: Ndërprerësit e tensionit për mbrojtjen nga mbirryma për instalimet shtëpiake dhe të ngjashme me to — Pjesa 2: Ndërprerësit e qarkut për veprimin e rrymës alternative dhe rrymës së vazhduar
- SSH EN 60947-5-4:2003:Pajisjet shpërndarëse të tensionit të ulët - Pjesa 5 - 4: Pajisjet e qarkut të kontrollit dhe elementët ndërprerës - Metoda e vlerësimit të performancës së kontakteve me energji të ulët - Prova të veçanta ( ose ekuivalentet e tyre)
- SSH HD 361 S3:1999 Sisteme per projektimin e kablllove
- SSH HD 361 S3:1999/A1:2006
- SSH HD 361 S3:1999/AC: 1999
- SSH HD 516 S2:1997: Udhezues per perdorimin e kablllove te harmonizuar te tensionit te ulet
- SSH HD 516 S2:1997/A1:2003
- SSH HD 516 S2:1997/A2:2008
- SSH HD 603 S1:1994: Kabllot e shperdarjes me tension te vleresuar 0,6/1 kV
- SSH HD 603 S1:1994/A1:1997
- SSH HD 603 S1:1994/A2:2003
- SSH HD 603 S1:1994/A3:2007
- SSH HD 604 S1:1994: Kabllot e fuqise 0,6/1 kV dhe 1,9/3,3 kV me performance speciale ndaj zjarrit per perdorim ne stacionet dektrike
- SSH HD 604 S1:1994/A1:1997
- SSH HD 604 S1:1994/A2:2002
- SSH HD 604 S1:1994/A3:2005
- SSH HD 605 S2:2008:Kablllo elektrik - Metodatat shtese te proves
- SSH HD 605 S2:1994/AC:2010
- SSH HD 627 S1:1996/A1:2000
- SSH HD 627 S1:1996/A2:2005

- SSH EN 50363-0:2011 Materialet e izolimit, mbuluese dhe veshese per kabllot e energjise me tensioni te ulet – Pjesa 0: Paraqitje e pergjithshme
- SSH EN 50363-3:2005: Materalat e izolimit, veshjes dhe mbulimit per kabllot elektrik te tensionit te ulet - Pjesa 3: Materalat elektroizoluese prej PVC-je
- S SH EN 50363-4-1:2005: Materalat e izolimit, veshjes dhe mbulimit per kabllot elektrik te tensionit te ulet - Pjesa 4-1: Materalat veshese prej PVC-je
- S SH EN 50363-4-2:2005: Materalat e izolimit, veshjes dhe mbulimit per kabllot elektrik te tensionit te ulet - Pjesa 4-1: Materalat mbuluese prej PVC-je
- SSH EN 50395:2005: Metodatat elektrike te testimit per kabllot elektrk te tensionit te ulet
- S SH EN 50396:2005: Metodatat jo elektrike te testimit per kabllot elektrk te tensionit te ulet
- SSH EN 60228:2005: Percjellesit e kabllrove te izoluar
- SSH IEC 60479 Efektet e rrymë mbi trupin e qënieve njërezore dhe bagëtime

### 3. ZONA E PROJEKTIT

#### i. Pozicioni Gjeografik

Ky projekt konsiston ne ndertimin e dy fiderave te rinj O1 dhe O2 me parametra 20kV me kabell gershet XLPE 3x(1x240)mm<sup>2</sup> ndertimin e 30 kabinave te reja tip box , rikonstrukcion te kabinave ekzistuese,ndertimin e linjes TU me kabell me vetembajtje ABC, nga N/ST Orikum i ri 110/35/20 kv.Keto fidera do te mbulojne zonen e Radhimes duke filluar nga ura e Orikumit deri ne Jonufer, duke garantuar furnizimin e panderprere me energji elektrike te kesaj zone turistike.




Figure 3 Zona ku do te zhvillohet projekti

### 4. PROJEKTI I RI

#### ii. Të përgjithshme

Rrjeti i sistemit të shpërndarjes mbart energji elektrike nga sistemi i transmetimit dhe ia dorëzon konsumatorëve nëpërmjet kabinave të transformacionit tip box ,muraturë ose shtyllore të cilat duhet të vendosen sa me afer qendrës së ngarkesës për të furnizuar me energji elektrike konsumatorët .

Rrjeti i shpërndarjes do të ndërtohet me kabell gershet 3x(1x240mm<sup>2</sup>) me izolacion 20kV. Nga N/St Fideri N/St Orikum i ri 110/35/20 kV do te ndertohen dy fidera te rinj O1 dhe O2.

Fideri i ri O1 do te lidhet ne unaze me fiderin Vj1 i cili del nga N/ST Vlora 2 110/20 Kv ne kabinen Lefter Sota.

Fideri i ri O2 do te lidhet ne unaze me fiderin Vj2 i cili del nga N/ST Vlora 2 110/20 Kv ne kabinen Stacion pompimi Sp7.

Një sistem unazor që ka lidhje të shumta me pika të tjera të furnizimit, zakonisht gjëndet më shumë zona urbane dhe ne objektet e rendesise se vecante. Këto pika të lidhjeve janë normalisht të hapura por lejojnë konfigurime të ndryshme nga rrjeti operativ. Operimi prej këtyre çelsave mund të jetë me telekomandë nga një qendër kontrolli ose nga një elektrikist me grup të lartë të sigurimit teknik që kryen manovrime në linja . Ky rrjet në rast defekti ose mirëmbajtje bën të mundur ndërprerjen e energjisë vetëm në kabinën e dëmtuar ose që kryhet remont.

### iii. Projekti I ndertimit te linjes 20kV dhe linjes TU me ABC përmban:

- Trasenë ku do te shtrihet fideri shk 1;1000. Linja të shtrihet në vende me akses në mënyrë që kushtet e shfrytëzimit dhe operimit të saj të jenë të sigurta për publikun. Marrja e masave të sigurimit teknik si të punëtorëve ashtu edhe të publikut.
- Skema e fiderit
- Seksionet dhe prerjet tërthore të kanaleve
- Hollësitë ndërtimore ,detajet teknike , betonimi , armimi dhe mbështetëset e tubacioneve etj. Punime Civile - Traseja e linjes TM duhet te zgjidhet e tille që të shfrytëzohet sa më pak kabëll. Kablli duhet të jetë i mbrojtur nga demtimet mekanike dhe mbinxehja. Kablli do te jete me izolacion xlpe 20kV me seksion 240mm<sup>2</sup>
- Makinerite dhe paisjet e nevojshme per zbatimin e punimeve
- Siguria në punë e punonjësve
- Kosto e llogaritur : Makineri Pajisje :Punime Montimi
- Specifikime teknike
- Në këtë projekt, i cili konsiston në projektin e detajuar të ndertimit te linjes TM 20KV dhe asaj TU me kabell ABC projektuesi është i kufizuar të ndjekë dhe te zbatojë shumicen e principeve, kritereve dhe kushteve aktuale të zhvillimit urban për realizimin me standartet e kërkuara dhe me kosto të leverdisshme
- Nga ana tjetër, bazuar në rishikimin e studimeve të mëparshme dhe diskutimeve me përfaqësues të Drejtorisë Rajonale Vlore, projektuesi është vënë në dijeni të vështirësive që mund të hasen në aspektin e funksionimit dhe operimit gjatë fazës së zbatimit të projektit.
- Projekti eshte hartuar në përputhje me kerkesat e rregullores së sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, instalimet dhe paisjet elektrike ,Kushtet teknike të projektimit (KTP) dhe kushte teknike të zbatimit ( KTZ ) që janë në fuqi.
- VKM 482//2020, Për miratimin e rregullës teknike, “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë se linjave elektrike me tension të lartë mbi 1 kV”, ”(ky rregull shfuqizon vetem piken 18 te KTP)
- VKM 483/2020, Për miratimin e rregullës teknike, “Për kushtet teknike dhe garantimin e sigurisë se instalimeve elektrike me tension të lartë mbi 1 kV”(ky rregull shfuqizon vetem piken 19 te KTP)
- Ligji 13/2013 “Per disa shtesa dhe ndryshime dhe ndryshime ne ligjin Nr 8734 ,date 01.02.2001 Per garantimin e sigurise se punes se pajisjeve dhe instalimeve elektrike i ndryshuar
- Ligji 8734 date 02.01.2001 Per garantimin e sigurise se punes se pajisjeve dhe instalimeve elektrike I ndryshuar
- Urdher nr 3403/1 Prot date 30.06.2003 Rregullore e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik per Impjantet Pajisjet dhe Instalimet Elektrike
- Ere kodit I matjes Vendimi nr 101 date 26.08.2008

### 5. Kriteret e projektimit

Kriteret e projektimit që përdoren për të përcaktuar llojin e linjës, tipin e kabllit të përdorur, fuqinë e transformatorëve të kabinave si janë prezantuar më poshtë.

#### iv. Kategoria e konsumatorëve

Konsumatorët janë ekzistues familjare dhe biznese . Kategoritë e konsumatorëve në zone karakterizohen nga një faktor fuqie prej 0.9 deri me 0.95 për këto arsye në llogaritjet që janë kryer në ngarkesa të ndryshme është marrë  $\cos\phi = (0.9 - 0.95)$ .

#### 1. Llogaritjet për përcaktimin e kabllit

Kablli që do të vendoset do jetë i tipit gershet me izolacion XLPE 20kV me seksion 240mm<sup>2</sup>, në përputhje me specifikimet e OSSH sh.a. dhe politikave të standartizimit që ka kompania si dhe në përputhje me detyrën e projektimit.

#### 2. Përcaktimi i tipit të kabinave

Kabinat e reja në rrjetin 20 kV do të ndërtohen tip BOX në përputhje me specifikimet e OSSH sh.a. dhe politikave të standartizimit që ka kompania si dhe në përputhje me detyrën e projektimit.

#### 3. Përcaktimi i ngarkesave në llogaritjet.

Gjatë projektimit është marrë në konsideratë që kabinat e transformacionit të ngarkohen deri në 80 % të fuqisë së tyre nominale, gjithashtu për llogaritjen e ngarkesës së secilës kabine është studiuar dhe ngarkesa e kabinave ekzistuese kur ky informacion ka qenë i disponueshëm. Në raste të tjera kur mungon informacioni janë përdorur dhe koeficientet e njëkohshmerisë me qëllim llogaritjen e fuqisë maksimale që një kabine ka në pik.



## v. Transporti

Te gjitha materialet dhe paisjet të transportohen deri në objektin që do të ndertohen linjat TM

## 6. SIGURIA NE PUNE

Atje ku punimet do të kryhen, në afersi të linjave ekzistuese të transmetimit, kablllove të fuqisë ose ndonjë pajisjeje elektrike në punë, kontraktori do të jetë përgjegjës për të marrë masa dhe të sigurojë personelin sipas rregullave në fuqi.

## 7. Koncepti i zbatimit

### i. Të përgjithshme

Në preventivin e këtij projekti vlera për truallin e kabines dhe për lejen e ndertimit nuk është përfshirë. Demontimet e linjave 10 kV dhe të ndonjë pjese të rrjetit do të kryhen nga punonjësit e OSSH-s të Drejtorisë Rajonale. Para fillimit të punimeve të meren lejet në institucionet përkatëse dhe të ribehet azhurnimi i trasës së linjës për të riparë strukturat e trasës nga ndryshimet e mundshme që mund të ketë pesuar. Për çdo ndryshim projekti të merret miratimi nga projektuesit.

Cdo kërkesë për ndryshim do të vlerësohet nga grupi projektimit.

Punimet të kryhen nën mbikqyrjen e personave fizike ose juridike të pajisur me çertifika profesionale përkatëse. Gjatë kryerjes së punimeve të zbatohet me rigorozitet rregullorja e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik.

### ii. Siguria në punë dhe në shfrytëzim.

Me poshtë do të japim një përshkrim të shkurtër të cilat duhet të merren në konsideratë gjatë zbatimit të punimeve por gjithmonë të zbatohet me rigorozitet rregullorët e sigurimit dhe të shfrytëzimit në fuqi.

#### **-Punimet civile.**

Gjatë punimeve të gërmimeve të merren masa në zbatim të rregullore për eliminimin e aksidenteve të mundshme. Sipas specifikimeve në projekt të profileve të kanaleve dherat e nxjerrë të largohen dhe kanali të mbushet me materialet e percaktuara sipas shtresave përkatëse. Gjatë punës së makinerive të ruhet distanca nga përcjellësit elektrik ajror egzistues, me qëllim mos rënien nën tension të punonjësve, kur është e nevojshme të kërkohet nga firma zbatuese stakimi i linjave gjatë kohës së punës.

#### **-Tokëzimi.**

Skerma e kablllove të linjave TM lidhet me impiantin e tokëzimit në N/ST dhe në çdo kabine. Në cdo muftë bashkuese të kablllove bëhet edhe lidhja elektrike sipas standarteve të skemës së kablllove më qëllim që ajo të ketë lidhje elektrike gjatë gjithë gjatësisë së kabllit deri në pikat ku bashkohet me impiantin e tokëzimit. Rezistenca e impiantit të tokëzimit të kabinave duhet të jetë,  $R_t \leq 2 \Omega$ . Të gjitha paisjet e kabinës tokëzohen si në projekt. Çelat e TM duhet të jenë sipas projektit dhe specifikimeve teknike bashkëngjitur me thika toke. Në linjat e tensionit të ulët realizohet tokëzimi i përsëritur i nulit cdo 150 m si në planimetritë të linjave TU përkatëse. Rezistenca e tokëzimit të përsëritur të nulit duhet të jetë  $R_t \leq 10 \Omega$ .

Principet kryesore të masave preventive për shëndetin dhe sigurinë mund të përmbledhen si më poshtë:

shmangia e risqeve

vlerësimi i risqeve

lufta kundër riskut në origjinë

adaptimi i punës për individin

adaptimi me progresin teknik

zëvendësimi i rrezikut nga jo ose me pak rrezik duke zhvilluar një politikë parandalimi

venia në plan të parë e masave mbrojtëse kolektive (mbi ato individuale)

Dhënia e instruksioneve të duhura për punonjësit

Punëtorët që punojnë janë të ekspozuar kundrejt temperaturave ekstreme, rreziqesh të rreshqitjeve dhe rreziqesh, zhurma ekstreme dhe vendeve jo të pastra. Shume nga kushtet e rrezikshme që punonjësit përballen mund të eliminohen. Rreziqet e tjera mund të reduktohen në masë të konsiderueshme.

Kështu që disa masa të shëndetit dhe sigurisë duhet të ndërmerren gjatë fazës së ndertimit por edhe gjatë fazës së operimit për të mbrojtur stafin kundrejt zhurmave, pluhurit, aksidenteve etj.

Keto masa mund të përmbledhen më poshtë:

Trainimi dhe edukimi rreth rrezikut të ujërave të përdorura dhe të zeza

Një vend larje dhe pastrimi pas punës

Pajisje mbrojtëse të përshtatshme, të tilla si doreza, çizme, mbrojtëse fytyre, kostume kundër ujit, – në varësi të tipit të punës

Shikim me sy të lirë, dhe kontrolli për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse për sytë dhe veshet dhe rrobat e sigurisë;

Mbaj pajisjet të pastra për të kufizuar ekspozimin tuaj kundrejt agjentëve që shkaktojnë sëmundjet

Ekzaminim i rregullt i shëndetit për stafin.

### iii. Analiza e Riskut

Implementimi i suksesshem i projektit presupozon përpjekje të dyanshme të Investitorit në bashkëpunim të ngushtë me supervizorin dhe Kontraktorin.

Për të shmangur riskun e lidhur me vonesat ose moszbatimin e aktiviteteve duhen konsideruar supozimet e mëposhtme:

Mbështetje e vazhdueshme dhe përfshirje aktive e strukturave të Divizionit të Shpërndarjes dhe Drejtorisë Rajonale Vlorë.

Bashkëpunim efektiv, interaktiv dhe i butë ndërmjet të gjithë mbështetësve të përfshirë në projekt.

Mbështetje e mjaftueshme dhe angazhim i institucioneve përgjegjëse për lejet përkatëse.

Zgjedhja e Supervizorit dhe Kontraktorit të kualifikuar.

Menaxhim i mirë i projektit dhe kontratës nga Kontraktori dhe Supervizori.

Aprovim në kohë i propozimeve dhe hapave të nevojshëm nga autoritetet përkatëse.

Kontrata duhet të implementohet me kujdes dhe transparencë. Takime të shpeshta Investitor-Kontraktor-Supervizor janë të nevojshme. Duhet të caktohet një pikë për koordinim.

Risqet e parashikuara të cilat mund të ndikojnë në realizimin me sukses të projektit janë si më poshtë:

Bashkëpunim i jo i mjaftueshem i institucioneve përkatëse të përfshira në lejet përkatëse.

Projekti mbivendoset me objektivat e nevojave të disa përfituesve (pronaret e pallateve ku ka kabina për rikonstruksion). E drejta për të hyrë në prona nuk është siguruar. Të zgjidhet mardhënia për funksionimin e investimit në kabina aktualisht private ose aktualisht informale. Të gjitha hartat kadastrale duhet të verifikohen për të siguruar disponueshmërinë e trasesë së linjave.

Mungesa ose vonesa e fondeve të implementimit. Mbpërdorim i burimeve financiare. Të gjitha lejet duhet të merren përpara fillimit të punimeve të projektit.

Problemet ambientale të paparashikuara. Probleme nëntokësore të paparashikuara. Ngjarje të natyrës (termete, permbytje, etj.) Kushte të ashpra të motit Vonesa në përfundimin e projektit, rritje të kostos së fuqisë njerëzore dhe kostos financiare. Ndërprerje ose heqja dorë nga projekti.

#### **iv. Çështjet ambientale**

Pas analizimit të projektit konstatojmë se kryesisht gjatë fazës së ndërtimit dhe jo gjatë operimit, do të ketë lëshime në atmosferë, të cilat duhet të monitorohen gjatë fazës së operimit si pluhuri, lëshimet në atmosferë të makinerive të përdorura gjatë zbatimit dhe operimit, zhurmat dhe nivelet e vibrimit. Ndikimet potenciale në ambient të projektit janë trajtuar gjerësisht në raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis që do të shoqëroje projektin.


Veprimet zbutëse për të parandaluar demet në ambient

Nga lagia gjatë gërmimeve, mbushje, skarifikimet dhe nivelimi gjatë ndërtimit, krijimi i pluhrave do të reduktohet. Skarpatat e gërmimit të formuara gjatë gërmimeve në zonë do të ngjeshen dhe ato do të lagen. Aktivitetet e ngarkim/shkarkimit do të ndërmerren duke patur kujdes për të mos lëshuar mbeturina. Kamionet do të jenë subjekt i kufizimit të shpejtësisë dhe gjatë transportit, ngarkesa duhet të mbulohet. Gjithashtu, mjetet e reja ose të mirëmbajtura do të përdoren sa më shumë të jetë e mundur dhe mjetet duhet të kalojnë testet përkatëse.

Faza e operimit:

Asnjë efekt të kundërt nuk do të ketë rrjeti i ri elektrik në cilësinë e ajrit dhe në ambient gjatë fazës së operimit.

#### **v. Foto nga gjendja ekzistuese, gjate azhornimit ne terren.**







#### vi. Dokumentacioni

Ky relacion është pjese e projektit "Zhvillimi i linjave TM 20kV,kabinave elektrike dhe linjat TU me percjelles ABC,per fiderat O1 dhe O2 nga N/Stacioni Orikum 110/35/20kV per furnizimin me energji elektrike te zones Radhime. "

” projekt i cili shoqërohet me dokumentacionin e më poshtëm:

1. Detyre Projektimi
2. Relacioni teknik
3. Vizatimet Detajet
4. Preventivat
5. Specifikimet teknike

#### 8. Referencat

DMRR. (2023). *Tabelat 1A*. Tirane: OSHEE.

DPZPS. (2023). *Standartet Teknike OSHEE*. Tirane: OSHEE.

DSHA. (2023). *Faturimet Maj-Arketimet Qershore*. Tirane: OSHEE.

VKM-Nr.216-Dt.13.04.2023. (2023). *VKM Nr. 216 Dt. 13.04.2023*.

*Shpërndarja e energjisë elektrike*. Tiranë, Shqipëri: MALUKA.

#### 9. GRUPI PROJEKTIMIT